



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

Drejtoria Komunale e Arsimit

Datë: 16.8.2023
Vendi: Rahovec
Nr. i ref.: 04/1105
Drejtori: Avni Morina



Në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 8, i Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr. 04/L-032, të datës 29.8.2011, nenit 34 dhe 35, të Ligjit për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-068, neni 5, paragrafi c, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, Nr. 05/2021, për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, shpall:

KONKURS

Për plotësimin e një (1) pozite të lirë të punës me kuadër profesional të arsimit, për vitin shkollor 2023/2024: Mësimdhënës/e për lëndën e Matematikës (zëvendësim lehone), në:

➤ ShFMU “Dëshmorët e Zatriqit” në Zatriq

- I. **Kushtet që duhet t’i plotësojnë kandidatët/et për të marrë pjesë në konkurs:**

Për vendin e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional sipas U.A. 05/2021, Udhëzimit Administrativ për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, ndërsa kualifikimet tjera që nuk janë në përputhje me këtë udhëzim administrativ nuk do të merren në konsideratë.
- II. **Dokumentet e nevojshme:**
 - Kopjen e diplomës së fakultetit të kryer, të noterizuar;
 - Kopjet e certifikatave të trajnimeve me bazë në shkollë;
 - Kopjen e ekstraktit të lindjes;
 - Kopjen e letërnjoftimit;
 - Dëshminë se nuk jeni nën hetime.
- III. **Mënyra e aplikimit:**

Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e aplikimit në DKA. Formulari i aplikimit merret/shkarkohet nga linku: <https://konkursi.rks-gov.net>
- IV. **Lista Pritëse:**

Kandidatët të cilët grumbullojnë më shumë se 50 pikë, hynë në listën pritëse si kandidatë fitues, dhe nëse paraqitet nevoja për ndonjë pozitë të lirë si Mësimdhënës/e për Lëndën e Matematikës, kanë të drejtë të punësohen.
- V. **Themelimi i marrëdhënies së punës:**

Marrëdhënia e punës themelohet nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës.
- VI. **Aplikimi në konkurs:**

Afati i aplikimit fillon nga data 15.9.2023 dhe zgjat 8 ditë kalendarike, me datë 22.9.2023, deri në orën 16:00.